

20232624548

## СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

### L I G J

#### **I GARANCISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT PËR DETYRIMET E MARRËVESHJES SË HUAS QË DO TË LIDHET NDËRMJET AGJENCISË FRANCEZE TË ZHVILLIMIT DHE SHA “BANKA ZHVILLIMORE E MAQEDONISË SË VERIUT” - SHKUP, PËR HUA TË SHA “BANKA ZHVILLIMORE E MAQEDONISË SË VERIUT” – SHKUP, PËR FINANCIMIN E INVESTIMEVE TË GJELBRA DHE ME PËRGJEGJËSI SHOQËRORE**

##### Neni 1

Republika e Maqedonisë së Veriut garanton përmbushjen e detyrimeve nga Marrëveshja e huas e cila do të lidhet ndërmjet Agjencisë Franceze të Zhvillimit dhe SHA “Banka Zhvillimore e Maqedonisë së Veriut” - Shkup, për huan e SHA “Banka Zhvillimore e Maqedonisë së Veriut” – Shkup, në vlerë prej 50.000.000 euro, për financimin e investimeve të gjelbra dhe me përgjegjësi shoqërore, nëse SHA “Banka Zhvillimore e Maqedonisë së Veriut” - Shkup nuk i përmbush dhe nuk i servison detyrimet në afatet dhe kushtet e përcaktuara sipas Marrëveshjes së huas.

##### Neni 2

Kushtet dhe mënyrën e shfrytëzimit të huas së nenit 1 të këtij ligji, përcaktohen në Marrëveshjen e huas që do të lidhet ndërmjet Agjencisë Franceze të Zhvillimit dhe SHA “Banka Zhvillimore e Maqedonisë së Veriut” - Shkup, për huan e SHA “Banka Zhvillimore e Maqedonisë së Veriut” – Shkup, për financimin e investimeve të gjelbra dhe me përgjegjësi shoqërore.

##### Neni 3

Të gjitha detyrimet financiare që rezultojnë nga Marrëveshja e huas e nenit 2 të këtij ligji, do t’i realizojë SHA “Banka Zhvillimore e Maqedonisë së Veriut” - Shkup.

##### Neni 4

Huaja e nenit 1 të këtij ligji do të tërhiqet më së shumti në 10 këste. Vlera minimale e këstit është 3.000.000 euro.

Periudha e shlyerjes së huas është 15 vjet, duke përfshirë periudhën grejs prej gjashtë vjetëve nga dita e nënshkrimit të Marrëveshjes së huas të nenit 2 të këtij ligji.

SHA “Banka Zhvillimore e Maqedonisë së Veriut” – Shkup do t’i paguajë Agjencisë Franceze të Zhvillimit provizion në vlerë prej 0.4% të vlerës së përgjithshme të huas në afat prej 30 ditëve nga dita e nënshkrimit të Marrëveshjes së huas.

SHA “Banka Zhvillimore e Maqedonisë së Veriut” - Shkup do t’i paguajë Agjencisë Franceze të Zhvillimit provizion për mjetet e patërhequra nga huaja në nivel vjetor si më poshtë:

a) Nga dita e nënshkrimit të Marrëveshjes së huas, deri në dyvjetorin e nënshkrimit të saj, SHA “Banka Zhvillimore e Maqedonisë së Veriut” - Shkup do të lirohet nga pagesa e provizionit për mjetet e patërhequra të huas.

b) Nga dyvjetori i nënshkrimit të Marrëveshjes psëer huas, deri në trevjetorin e nënshkrimit të saj, SHA “Banka Zhvillimore e Maqedonisë së Veriut” - Shkup do t’i paguajë Agjencisë Franceze të Zhvillimit provizion për mjetet e patërhequra të huas në vlerë prej 0.15% në nivel vjetor.

c) Nga trevjetori i nënshkrimit të Marrëveshjes së huas, deri ditën e tërheqjes së trashesë së fundit të huas, SHA “Banka Zhvillimore e Maqedonisë së Veriut” – Shkup, do t’i paguajë Agjencisë Franceze të Zhvillimit provizion për mjetet e patërhequra të huajs në vlerë prej 0.25% në nivel vjetor.

#### Neni 5

Norma e interesit do të përcaktohet për çdo këst të huas veçmas, sipas Marrëveshjes së huas.

#### Neni 6

Për rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve të ndërsjella që rezultojnë nga Marrëveshja e huas dhe nga Marrëveshja e garancisë të nenit 2 të këtij ligji, Ministria e Financave dhe SHA “Banka Zhvillimore e Maqedonisë së Veriut” – Shkup, do të lidhin marrëveshje të posaçme.

#### Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.